

PYETJE

Pagesat Mjore

LEKSIONET MUZIKORE

Si funksionojnë pagesat mjore?

Pagesat mjore në Akademinë Hollywood nisin prej 1 Tetorit deri më 21 Qershor, ku ju ofrohen 36 javë leksioneve të ndara në tre trimestra.

Nga data 1 Tetor - 12 Javë.

Nga Janari - 12 Javë dhe nga fundi i muajit Mars 12 Javë Deri më 21 Qershor.

Çdo trimestër ju ju ofrohen 12 javë leksioneve, ku i bie 12 leksione për mënyrën që vijnë një herë në javë, dhe 24 leksione për ata që vijnë dy herë në javë.

Në këto 12 javë leksioneve, që ofrohen në tri muaj, pagesa është fikse, e pandryshueshme dhe juve mund t'ju qëllojë të keni 3 leksione në një muaj, dhe 5 në muajin tjetër, por totali në tri muaj do të jetë 12 javë.

Për këtë mund të shqyrtoni kalendarin tonë, ku trimestrat janë më të gjatë.

Pagesat mjore janë për fëmijët nga 5-18 Vjeç.

Çfarë ndodh nëse nuk paraqitem në leksion? A duhet ta pagua?

Ne do ju luteshim që në rast se nuk do arrihi të vini në leksion të na lajmëroni brenda mundësive. Leksionet e anuluarat brenda ditës nuk janë të zëvendësueshëm.

Çfarë është rregulli i anulimit 24 orë?

Duke qenë që klasa dhe profesor ka orarin e zënë veç për ju çdo javë (ose dy herë në javë) në respekt të kohës, do ju luteshim të na lajmëroni 24 orë përpara për anulim, nëse dëshironi që ta zëvendësoni leksionin. Zëvendësimet 24 orë përpara mund të kryehen vetëm 1 herë në trimestër.

Nëse dua të ndërpres leksionet e muzikës, sa kohë përpara duhet të lajmëroji.

Do ju luteshim që për të respektuar kohën tonë, të na jepni 2 deri 3 javë përpara se të shkëputeni.

Kini parasysh, që tarifat mjore janë bërë për të qenë më të kollajta për të gjithë ne, dhe nëse ju shkëputeni në mes apo para përfundimit të trimësht, atëherë do na duhet të llogarisim totalin e leksioneve të marra dhe pagesës që keni kryer. Pra x/12 të javëve të leksioneve dhe x/3 të pagesave mjore për të patur një qartësi dhe transparencë të pagesave dhe leksioneve.



Akademia Hollywood
Rruga Qemal Stafa 206/1
Tirana, Albania

Pagesat Kolektive

Si funksionojnë pagesat kolektive?

Pagesat për të gjitha klasat në grup, janë 10 javore.

Sa kohë zgjat një kurs me pagesat kolektive?

Për t'ju patur në vëmendje është që klasat me pagesa kolektive janë klasa vjetore.

Pra klasa që nisin prej Shtatorit Deri në Qershor, dhe thjesht pagesa e tyre është 10 javore.

Nëse janë pushimet dimërore, a quhen kredit të humbura?

Kini parasysh, që me pagesa 10 javore nënkuptojmë 10 javë leksioneve.

Pra nëse Akademia Hollywood është e mbyllur atëherë nuk debitchet krediti juaj.

Nëse duhet të shkëputem, kur duhet t'ju lajmëroji?

Shumë nga klasat kolektive si Teatër, Ansambël, Rock101 janë të ndërtuara në si Grupe që punojnë me njëri tjetrin, dhe nëse ju doni të shkëputeni, ju lutem na lajmëroni sa më përpara që mundeni, që kështu mundësi juaj mos të ndikojë në vijueshmërinë e punës në klasë.

Klasat kolektive janë një punë në ekip dhe kanë nevojë për bashkëpunimin e të gjithëve.

Nëse shkëputem përpara se të bëj 10 leksione a mund të më kthehet pagesa?

Pagesa për klasat kolektive mund t'ju kthehet vetëm pas leksionit të parë.

Më pas pagesa është e pakthyeshme.

Pagesat e koncerteve

Përse duhet të paguajmë kontribute për koncerte?

Kontributet e pjesëmarrësve për koncerte apo shfaqje janë e vetmja mundësi financiare që ne kemi për të realizuar shfaqjet apo koncertet.

Në shpërzim të merr një koncert, injnë si Qeraja e sallës, pritme pa fund, Koha e startit që është aty për ju, fotografi dhe kameramani dhe shpeshherë dhe pastiri i sallës.

Ju Falënderim!